



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 16.09.2019, ora 10.30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i projektligjit: “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” (në anglisht, Albanian Investment Corporation), është iniciuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Anastas Angjeli, Artemis Dralo (Malo), Senida Mesi, Ervin Bushati, Vullnet Sinaj, Reme Lala, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Suzana Topi, Krenar Ryci, Evis Kushi,

Mungojnë:

Arben Elezi, Korab Lita, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti,

Të ftuar:

Elton Haxhi - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomise,

Ervin Mete - Drejtor i Kabinetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomise,

Saimir Mucmataj - Drejtor Drejtorie, në Ministrinë Financave dhe Ekonomise,

Arvid Uruci – Përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomise,

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj - Dhe në dijeninë time, qeveria ka rënë dakord për disa ndryshime në disa nene për të reflektuar shqetësime, opinione apo ndryshime që Komisioni Europian i ka ofruar qeverisë për draftligjin.

Ndërkohë, siç e theksova, sot do ta diskutojmë dhe kalojmë në parim.

Zoti Haxhi do të informojë ministren dhe KM-në, nëpërmjet ministres, që drafti i ardhur me ndryshime nuk është draft ligjor, që do të thotë se sot ne do ta diskutojmë në parim dhe gjatë javës do të presim të na vijnë ndryshimet, në bazë të Rregullores së Kuvendit, të firmosura nga autoritetet, se ndryshimet e ardhura nga sekretarja e ministres ne nuk mund t'i konsiderojmë.

Do t'ju tërhiqja vëmendjen edhe juve, edhe ministres që të mos më dërgoni më shkresa jozyrtare nëpërmjet autoriteteve, që nuk reflektohen në protokollin e Kuvendit. Do t'ju lutesha!

Urdhëroni!

Krenar Rryçi – Unë kam dy kërkesa të vogla:

1. Pyetjet të bëhen një nga një dhe përgjigjet të merren një nga një.
2. Herën tjetër mirë është që të jetë ministrja këtu, sepse unë e konsideroj këtë një ligj shumë të rëndësishëm.

Arben Ahmetaj – Ministrja kishte një aktivitet shumë të rëndësishëm në një zonë të Shqipërisë, prandaj i dhamë leje, por e drejtë është kjo që thoni ju.

Jam dakord që pyetjet të bëhen një nga një.

Relatore është zonja Reme Lala.

Unë mendoj të fillojmë me relatoren, pastaj të kalojmë te zëvendësministri, pyetje apo opinione për draftligjin në parim dhe në fund të votojmë.

Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Reme Lala!

Reme Lala – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji “Për korporatën e investimeve shqiptare” është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Projektligji është hartuar në bashkëpunim me ekspertët e Universitetit të Harvardit, me Qendrën për Zhvillim Ndërkombëtar (CID).

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai bazohet në nenet 78, 83 pika 1, të Kushtetutës dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

Një ndër sfidat më të mëdha të qeverisë shqiptare është ajo e përshpejtimin të rritjes ekonomike. Në këtë frymë, vlerësohet se përshpejtimi i rritjes ekonomike, ndër të tjera, mund të arrihet përmes zgjerimit të kapacitetit të ekonomisë për të identifikuar, përgatitur dhe ekzekutuar projekte investimi me impakt të gjerë, që kërkojnë shfrytëzimin e aseteve shtetërore, si dhe mobilizimin e kapitalit privat.

Këto projekte investimi, për shkak të rëndësisë dhe impaktit që kanë, nuk mund të realizohen në mënyrë të pavarur nga sektori privat pa përfshirjen në një masë të konsiderueshme të shtetit, kryesisht në procesin e dhënies së autorizimeve të nevojshme për qëllimin që kërkohet të realizohet dhe vënies në dispozicion të aseteve.

Për të mundësuar sa më sipër përmenda, është vlerësuar ei nevojshëm krijimi i një institucioni të posaçëm, që të konceptualizojë projekte dhe të sigurojë kombinimin e duhur të aseteve shtetërore me investimet private.

Projektligji që po shqyrtojmë sot ka për qëllim pikërisht krijimin e një strukture të konceptuar në formën e një korporate, pra, më konkretisht, krijimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare, si dhe përcaktimin e rregullave për organizimin e funksionimin e veprimtarisë së saj.

Korporata e investimeve është konceptuar të ketë kapacitetin për të transformuar ide dhe nisma investimesh në projekte të financueshme dhe tërheqjen e interesit nga investitorë cilësorë, duke përdorur më mirë dhe më me efektivitet e eficiencë, token dhe/ose asetet e tjera në pronësi të saj dhe të përgatisë projekte që, nëse vlerësohen të përshtatshme, mund të financohen.

Për gjithë sa më sipër përmenda është i domosdoshëm mundësimi i një kuadri ligjor të konsoliduar institucional. Theksoj se krijimi i institucioneve të tilla është një eksperiencë e ndjekur edhe nga shumë vende të tjera.

Objekti i veprimtarisë së korporatës do të jetë përmirësimi i menaxhimit të pronës publike, krijimi i pronave të reja, vënia në përdorim më eficient të pronave, përgatitja dhe zbatimi i projekteve të investimit dhe mobilizimi i kapitalit shtetëror ose privat, me qëllim kryerjen e investimeve në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

Korporata është konceptuar dhe krijohet si shoqëri tregtare, e organizuar në formën e një shoqërie aksionare, ku ministri përgjegjës për ekonominë do të jetë në cilësinë e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të korporatës. Projektligji, gjithashtu, parashikon mundësinë që aksione të Korporatës, të mund të zotërohen edhe nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare të Zhvillimit.

Kjo strukturë nuk ekziston aktualisht në ekosistemin e agjencive në vend dhe as në sektorin privat. Korporata është konceptuar si një njësi me thelbin e një fondi investimesh, por me qëllim të përcaktuar për zhvillimin ekonomik të vendit, pra, është konceptuar si një institucion që do të jetë në gjendje të përfaqësojë qeverinë shqiptare në menaxhimin e aseteve strategjike dhe në maksimizimin e mobilizimit të kapitalit privat, të marrë përsipër shfaqjen e riskut në projektet strategjike dhe, gjithashtu, të bashkëpunojë me institucione financiare ndërkombëtare dhe sektorin privat.

Efektet e funksionimit të Korporatës do të ndihen në krijimin dhe forcimin e hallkave ekonomike rreth projekteve të investimit, që do të kryejë korporata: rritjen e punësimit, transformimin e zonave, ku do të bëhen investimet e Korporatës, lehtësimin për tërheqjen e investorëve dhe shtimin e marrëdhënieve ndërmjet sektorit publik e privat.

Fusha e veprimtarisë dhe mjetet që i duhen korporatës për të kryer funksionet e parashikuara kërkojnë përgatitjen e kuadrit ligjor specifik dhe për këtë qëllim ky projektligj do të pasohet edhe nga disa vendime të Këshillit të Ministrave, për të bërë të mundur rregullimin e plotë të veprimtarisë së korporatës, në funksion të efektivitetit në përmbushjen e funksioneve dhe misionit të saj, pajtueshmërinë me sistemin ligjor dhe bashkëpunimin me institucione të tjera publike ose ndërkombëtare.

Miratimi i projektligjit do të shoqërohet me kosto financiare, pasi krijon strukturë të re shtetërore.

Për vitin 2019, nga buxheti i shtetit është parashikuar një fond buxhetor prej 368 milionë lekësh, në buxhetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si kapital fillestar për korporatën.

Për gjithë sa më sipër analizova, duke vlerësuar se miratimi i këtij projektligji do të ndikojë pozitivisht në përsheptimin e rritjes ekonomike, përmes zgjerimit të kapacitetit të dhe Ekonomisë për të identifikuar, për të përgatitur dhe për të ekzekutuar projekte investimi me impakt të gjerë që kërkojnë shfrytëzimin e aseteve shtetërore, si dhe mobilizimin e kapitalit privat. Ju rekomandoj anëtarëve që ta miratojnë atë.

Faleminderit!

Zoti kryetar, nëse mundem, kam një pyetje.

Arben Ahmetaj – Patjetër, kur të vijë seanca e pyetjeve. Një sqarim edhe për anëtarët e komisionit, por edhe për medien. Në momentin që hartuam draftin, së bashku me grupin e Universitetit të Harvardit bëmë edhe një konsultë të gjerë, qoftë me Bankën Europiane të Investimeve, qoftë me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe mbështetja ishte dhe është e plotë për konceptin. Për të qenë të drejtë dhe realistë këto

institucione ishin në harmoni me shqetësimet që kishte komisioni dhe i gjithë procesi për të dëgjuar institucionet ndërkombëtare që nesër do të jenë qoftë partnerë, qoftë mbështetës me projekte dhe me fonde.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, qetësi!

Më vjen mirë që pas konsultimeve të gjata është rënë dakord totalisht për draftin e ri, dua të quaj të tillë me komisionin dhe me institucionet ndërkombëtare.

Po, zoti Zëvendësministër.

Elton Haxhi – Përsëritje!

I nderuar kryetar,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Pa përsëritur ato aspekte të projektligjit që përmendi relatorja, qëllimi dhe objekti i punës së korporatës besoj se janë të qarta.

Unë do të ndalem në 2-3 momente të tjera, të cilat adreson projektligji. Në radhë të parë është pavarësia. Korporata Shqiptare e Investimeve do të jetë një subjekt i ligjit “Për shoqëritë tregtare” me një strukturë qeverisje që siguron distancën nga Administrata Publike dhe nga kompanitë e tjera me kapital publik. MFE-ja do të jetë aksionere dhe bordi këshillimor, i cili është një strukturë tjetër, e cila do të shërbejë për vlerësimin e investimeve ku do të përfshihet korporata, do të ketë përfaqësues të institucioneve qendrore, por edhe të institucioneve financiare ndërkombëtare.

Një element tjetër është roli i qeverisë. Siç e përmendëm Ministria e Ekonomisë do të jetë në rolin e aksionerit dhe 2 strukturat e tjera të cilat do të bëjnë të mundur mbikëqyrjen qoftë këshilli i mbikëqyrjes, qoftë bordi këshillimor, do të ruajnë pavarësinë që do të ketë kjo korporatë nga qeveria. Përveç kapitalit fillestar prej 368 milionë lekësh, që është kontribut nga buxheti i shtetit, korporata mund të sigurojë edhe burime të tjera financimi qoftë nga institucionet ndërkombëtare apo duke u futur në projekte të përbashkëta me investitorët privatë. Auditimi i korporatës është një çështje tjetër, e cila është adresuar në projektligj. Korporata do të jetë subjekt i auditimit bazuar në ligjin “Për auditimin ligjor dhe ekspertët kontabël të regjistruar dhe kontabilitetin”. Në të njëjtën kohë për të gjitha burimet të cilat vijnë nga fondet publike do të jetë subjekt dhe i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Gjithashtu, janë përcaktuar edhe parimet e prokurimit. Kemi 3 modele prokurimi, të cilat janë parashikuar në projektligj: nëse fondet janë nga buxheti i shtetit, zbatohen rregullat e prokurimit publik, nëse fondet janë nga donatorë të huaj zbatohen rregullat e

donatorit apo të institucionit financiar ndërkombëtar, nëse fondet janë të përbashkëta dhe shumica janë nga donatori, atëherë vendoset në marrëveshje midis tyre nëse do të jenë rregullat e prokurimit publik apo rregullat e donatorit.

Siç e thashë korporata, projektligji është kujdesur që të sigurojë një mbështetje sa më të madhe ndërkombëtare dhe për këtë arsye janë lënë edhe disa vende për anëtarë nga këto institucione ndërkombëtare për të siguruar një vlerësim të drejtë dhe sa më cilësor të projekteve të investimit.

Ashtu siç u përmend edhe këtu ligji është dakordësuar dhe ka reflektuar të gjitha komentet e Komisionit European. Kjo gjë është konfirmuar edhe me shkresë zyrtare nga ky i fundit. Për më tepër nëse ka pyetje, jemi të gatshëm që t'u përgjigjemi atyre.

Arben Ahmetaj – Më falni!

Ju lutem, a mund të vendosni në dispozicion të komisionit zyrtarisht letrën e Komisionit European?

Elton Haxhi - Po.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Duam zyrtarisht një kopje.

Elton Haxhi - Po, do ta depozitojmë në sekretari.

Arben Ahmetaj - Ju lutem, duhet ta depozitoni sot, pasi do t'u shpërndahet anëtarëve të komisionit që të shikojnë komunikimin që ka Komisioni European me qeverinë.

Kush ka pyetje? Po, zonja Mesi.

Senida Mesi – Përshëndetje të gjithëve!

Ju falënderoj për përmbledhjen!

Sikurse e thashë, dua së pari të tërheq vëmendjen se ne këtu si anëtarë të Komisionit të Ekonomisë kemi një draft, i cili nuk qenka drafti përfundimtar. Jam dakord me zotin kryetar, kur tha se duam jo vetëm shkresën përcjellëse, por edhe draftin final të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, që t'i referohemi një drafti penal dhe jo të punojmë me një draft të draftit, i cili na qenka jashtë çdo funksioni, le të themi.

Faktikisht, unë kam disa pyetje, të cilat do të doja që ju t'i merrnit parasysht në momentin që ne sqarojmë këtë ligj nen për nen, duke filluar më së pari me relacionin.

Si ndërthuret, si përputhet? A ka mospërputhje apo mbivendosje ky ligj, në krahasim me disa ligje që ne kemi në fuqi? Ligjet që ne kemi fuqi, të cilat merren me pjesën e investimeve strategjike, me promovimin, me monitorimin, nxitjen dhe bërjen e projekteve, si dhe vënien e tyre në funksion, janë disa. Kemi ligj për Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit për menaxhimin e disa aseteve dhe pronave ka krijuar edhe Agjencinë

Ekonomike Ndhmëse, e cila është një formë ligjore, sh. p. k., ka statutin dhe aktin e themelimit të saj. Ne kemi një tjetër agjenci shtetërore, që quhet AIDA, e cila është Agjencia e Nxitjes dhe Zhvillimit të Investimeve në Shqipëri, që janë të huaja dhe vendase. Ajo ka rregulloren e statutin e vet. dhe sigurisht që i referohet ligjeve të tjera në fuqi. Vetë ligji i investimeve të huaja dhe strategjike, si këto ligje, ndërthuren me ligjin aktual. A e keni analizuar ndonjëherë sa mospërputhje, sa ndihmëse mund të jenë për njëra-tjetrën apo dhe sa mbivendosje mund ketë?

Pika e dytë, të cilën faktikisht e sqaruat, është në lidhje me prokurimet, kështu që unë po pres versionin final të ministrisë dhe shkresën zyrtare të Komisionit European, meqë paskan punuar, për t'i referuar pastaj ndarjes: fonde publike, buxhetore, në bazë të ligjit "Për prokurimin publik". Është shumë e rëndësishme për të vendosur nëse kemi investime, të cilat janë së bashku, përqindje të caktuara buxheti i shtetit dhe përqindje të tjera donatorë të huaj. Si do të vendoset?

Ne e dimë shumë mirë se një lek që është nga të ardhurat e qytetarëve shqiptarë, që është një lek publik dhe i buxhetit, duhet të prokurohet në bazë të ligjeve në fuqi. Këtë nuk mund ta vendosë asnjë institucion i huaj, për sa kohë që ne kemi një ligj, i cili prevalon mbi ligjet e tjera. Në lidhje me konsultimin publik, besoj se ka kaluar një proces shumë të gjatë, sepse vetë ligji ka pothuajse mbi gjashtë muaj apo një vit që qarkullon në grupe të ndryshme të interesit, unë do të doja që ju t'i paraqisni Komisionit të Ekonomisë përmbledhjen e sugjerimeve të të gjitha grupeve të interesit. Si e kanë parë ata këtë ligj dhe cilat kane qenë rekomandimet dhe sugjerimet e tyre?

Pika e tretë, shumë e rëndësishme, e cila duhet të jetë pjesë e relacionit, duke pasur ndërthurje me shumë ligje të tjera në fuqi, me institucione, agjenci apo drejtori brenda për brenda ministrisë, është: si e afekton ky ligj edhe administratën publike, mirëmenaxhimin e saj, drejtoritë ekzistuese brenda për brenda ministrisë apo dhe jashtë ministrisë, institucione të tjera që janë nën varësinë e ministrisë, në momentin që hyn në fuqi?

Kemi shumë drejtori brenda për brenda ministrive, që merren pikërisht me disa nga pikat kryesore të objektit të këtij ligji. Pra, që të mos kemi më struktura paralele, si dhe për të sqaruar se cili është roli i administratës publike, në momentin kur ky ligj hyn në fuqi.

Ju faleminderit!

Arben Ahmetaj – Zoti Haxhi, patjetër.

Zoti Haxhi, megjithëse pyetjes e zonjës Enida hyjnë edhe në nen për nen, do t'ju kërkoja të qëndronit në parim, pra parimisht te koncepti i AIC-së. Patjetër që është e rëndësishme të preket parimi i prokurimeve, sepse është bërë shumë zhurmë mbi asgjë, sa u

takon procedurave të prokurimit, ndërkohë që drafti i ka të shkruara e zezë në të bardhë, që ato janë procedura të prokurimit publik, ose në bazë të procedurave të donatorëve, kur paratë, investimi apo mbështetja, financimi ose projekti janë nga donatorët.

Gjithsesi, ju lutem që fokusin ta mbani tek parimet.

Elton Haxhi – Faleminderit!

Atëherë, në parim korporata është subjekt i ligjit “Për shoqëritë tregtare”. Thënë kjo, ndërhyrja e shtetit apo influenca e shtetit është e kufizuar për sa i përket kapitalit fillestar dhe emërimit të një numri të caktuar të anëtarëve në këshillin mbikëqyrës. E gjithë pjesa tjetër e veprimtarisë do të organizohet dhe do të funksionojë bazuar në këtë ligj dhe në statutin e korporatës.

Për sa i përket konfliktit apo mbivendosjes me legjislacionin që ju përmendët, gjithnjë në parim po flas, do të jetë një korporatë e cila do të ketë të njëjtin trajtim si dhe kompanitë e tjera, të cilat aplikojnë për projekte strategjike dhe marrin një status të caktuar.

Strukturat e Ministrisë së Financave apo të institucioneve të tjera do të kenë të njëjtin mbikëqyrje apo të njëjtin funksion, siç kanë edhe kompanitë e tjera shtetërore në lidhje me rolin e aksionarit.

Pjesa tjetër do të trajtohet siç trajtohen edhe investimet e tjera strategjike apo ligji i ri i investimeve, i cili po punohet, dhe që do të miratohet së shpejti, i cili do të parashikojë edhe trajtimin e investimeve në këtë aspekt.

Arben Ahmetaj – Më fal, zoti Haxhi! Të lutem, mos të shpërndahe mi! Agjencia vepron në bazë të këtij ligji, kur të bëhet ligj i veçantë. Nuk është pjesë e administratës publike, nuk ka të njëjtin profil, le të themi, siç ka Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Jemi duke folur për një korporatë në vetvete, e cila në mundësi do të jetë edhe një urë midis privatit dhe qeverisë, ose gjithashtu një urë mes qeverisë dhe donatorëve, në lidhje me projekte të veçanta. Nuk ka lidhje fare me profilin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, që funksionon me fonde donatorësh, të cilat janë purifikisht investime publike, të cilat bien brenda bilancit, buxhetit të shtetit. Këtu jemi duke folur për projekte private ose partneriteti me donatorët, jo për ato që janë brenda buxhetit të shtetit.

Zoti Haxhi, është shumë e rëndësishme për qytetarët dhe për deputetët të vihen pikat mbi “i”, sepse me të drejtë zonja Senida pyet. Janë tri institucione, Agjencia e Investimeve të Huaja... Me të drejtë një qytetar, gazetar apo deputet që e dëgjon fillon dhe bëhet konfuz dhe thotë: “Pse po replikojnë institucionet?” Ndërkohë, ky nuk është replikim institucioni, përkundrazi është hera e parë që kemi një profil institucioni të kësaj natyre.

Më pas, kur të vijmë në diskutimin nën për nën, duhet ta theksojmë disa herë që vetëm kapitali fillestar investohet nga buxheti i shtetit dhe më pas Agjencia, në bazë të ligjeve të prokurimit publik, të transferimit të aseteve, ligje që janë të konsolidura në Republikën e Shqipërisë për trajtimin e aseteve publike, do të marrë asistencë publike për t'i trajtuar në projekte të ndryshme. Janë shumë të rëndësishme të thuhet këto, zoti Haxhi. Unë mendoj se nuk duhet t'i referoheni asnjë ligji tjetër për funksionin, sepse kemi një draftligj, i cili pikërisht për funksionin e kësaj Agjencie po hartohet.

Po, zoti Haxhi.

Elton Haxhi – Në lidhje me rregullat e prokurimit projektligji parashikon, ashtu siç e thashë edhe në fjalën time në fillim, tre modele. Nëse fondet janë buxhetore, janë plotësisht nën kontrollin e KLSH-së dhe prokurimi kryhet sipas ligjit të prokurimit publik; nëse fondet janë të një institucioni financiar ndërkombëtar, ato do të jenë subjekt i prokurimit, sipas rregullave të donatorit apo të investitorit dhe nëse shumica e financimit vjen nga një institucion ndërkombëtar, ku merr pjesë edhe buxheti i shtetit, por me më pak se 50%, kjo do të caktohet përsëri me marrëveshje.

Synimi është që korporata të ketë zërin e saj për të kërkuar që edhe këto fonde të prokurohen sipas ligjit të prokurimit publik. Por, duke qenë se shumica e fondeve është e përcaktuar që të jetë nga një institucion financiar ndërkombëtar, atëherë duhet gjetur kjo marrëveshje për të caktuar rregullat e prokurimit, sepse ai ka shumicën e financimit. Nuk do të ishte e drejtë që projektligji të përcaktonte në mënyrë të detyrueshme rregullat e prokurimit publik edhe në rastet kur buxheti i shtetit financon më pak se 50%.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Haxhi!

Po, zonjë.

Edlira Hyseni – Përshëndetje!

Ju falënderoj për shpjegimet që na dhatë!

Ne kemi përpara një ligj të rëndësishëm, i cili nuk besoj se është kaq i thjeshtë sesa duket dhe me probleme thjesht parimore apo elementare.

(Diskutime pa mikrofon)

Jemi te pjesa e pyetjeve dhe jo e komenteve?

(Diskutime pa mikrofon)

E kam gjithmonë këtë problem me kryetarin.

Sa i takon këtij ligji, të cilin e konsideroj shumë të rëndësishëm dhe një ndryshim të madh, i cili kërkon informacion dhe analizë, do ta nisja me një vërejtje sa i takon relacionit që shoqëron projektligjin. Në materialin që na është përcjellë me *e-mail* (po t'i shihni, kemi pesë

herë të njëjtin dokument, i cili është thjesht projektligji, por në mënyra të ndryshme, në PDF, Word, herë kështu e ashtu), por edhe vetë relacioni që e shoqëron atë, nuk e di se sa faqe ka në përgjithësi, por përveç dy faqeve të para, në të cilat flitet me fjalë të përgjithshme lidhur me rëndësinë e menaxhimit, shtatë faqet e tjera janë përsëritje e projektligjit me shpjegime elementare.

Unë dua të di, besoj se ju keni kohë që punoni me këtë ligj dhe jeni më të mirinformuar më shumë sesa ne që njihemi sot me të, a nuk ka informacione të tjera pak më konkrete, më të detajuara dhe me shembuj më ilustrativë për të na thënë se pse lindi domosdoshmëria e krijimit të kësaj korporate? Cilat vende në Europë apo përreth nesh, vende që ne i njohim dhe mund t'i marrim si modele, e kanë identik një korporatë të tillë dhe ka rezultuar si model i suksesshëm?

Pyetja e parë është, kjo mungesë informacioni në këtë relacion, e cila mua më duket përsëritje e projektligjit me shpjegime shumë të vakta, është sepse nuk ka informacione të tjera, gjithsesi ligji do të kalojë edhe pse nuk ka informacione apo ka neglizhencë në elemente më të detajuara që ne të na bëjë të kuptojmë pse lindi domosdoshmëria. Kur lindi? Çfarë shifrash konkrete ka apo një shembull se si do të funksionojë dhe çfarë do të bëjmë në praktikë? Unë dua të di diçka që të gjithë ne ta kemi më të qartë, pra çfarë është dhe pse është? Kjo është pyetja e parë, e cila lidhet me relacionin.

Gjithashtu, ashtu siç e tha edhe kryetari, por edhe për mua qëndron çështja e Komisionit European së cilës ju i referoheni disa herë. Unë mendoj se do të ishte mirë që ne të dinim se cili ka qenë raporti i Komisionit European, sugjerimet apo rekomandimet që janë bërë.

Pyetja e dytë, po vazhdoj me elemente pak më të thjeshta. Nëse ky projektligj ka mjaft kohë që debatohet dhe analizohet nëpër tavolina, pse nuk ka qenë pjesë e projektakteve të miratuara të 2019-ës, por del si një ligj i papritur në planet qeverisëse të vitit 2019? Në relacion thuhet: “Ky projektligj nuk është pjesë e projektakteve apo të parashikimeve të buxhetit për vitin 2019”.

A është e saktë? Përderisa ka kohë që diskutohen nevojat, si ka mundësi që kjo është lënë jashtë parashikimeve buxhetore të vitit 2019?

Arben Ahmetaj – Më falni, por në buxhetin e vitit 2019 unë kam qenë ministër Financash në atë kohë dhe e di sa është vendosur për zërin e AIC-së, janë vendosur 360 milionë lekë.

Relacioni është tjetër gjë.

Pra, së pari, është në buxhet, së dyti, ka ardhur si draft i aprovuar nga Këshilli i Ministrave, së treti, është në planin e Kuvendit dy herë, në korrik dhe në shtator. Pra, është i planifikuar, por, siç duket, Ministria e Financave ka futur pa dashje “nuk” dhe duket sikur nuk është, por, në fakt, është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne jemi duke diskutuar në parim sot. Mos u merrni me këto, por merrni me thelbin. Zëvendësministri tha se është parashikuar në buxhet, unë po them se është parashikuar në buxhet zë më vete, ka qenë dy herë pjesë e programit, ka qenë disa herë pjesë e debatit.

Anastas Angjeli - Tani jemi në shtator, kemi edhe dy javë që ta miratojmë, do të qëndrojë edhe një muaj te presidenti dhe do të hyjë në fuqi. Mos u shqetësoni, është e zgjidhur!

Elton Haxhi - Në lidhje me parashikimin dhe relacionin, në pikën 2 të relacionit në faqen 2 është përmendur dhe nuk ka asnjë lapsus ky projektligj.

Arben Ahmetaj- Po pse i kthehesh gabimit. Ai është një lapsus që kur e ke shkruar ti relacionin, është futur pa dashje një, nuk në lidhje me buxhetin.

Elton Haxhi- Shembujt që mund të sjell janë disa: Singapuri ka një koorparatë të ngjashme, Jordania ka një koorparatë të ngjashme, shumë të suksesshme, Kanadaja, po ashtu.

(Ndërprerje incizimi)

Edlira Hyseni- Sipas projektligjit, kur koorparata identifikon një pronë me leverdi kudo ajo është, pushteti lokal i kërkon qeverisë që ta transferojë tek ajo. Më duket si shpend grabitqar që, kur identifikon diçka të vlefshme dhe të leverdishme, do ta përvetësojë, kështu që më duket pak e frikshme si deklaratë, “kur e identifikon”. Pyetja ime është: mos ka një mospërputhje ose prekje të pavarësisë dhe autonomisë së pushtetit lokal, i cili ato prona i zotëron ose mund t’i ketë idetë e veta si do t’i zhvillojë? A ka të drejtë ta refuzojë, ta themi pushteti lokal kërkesën e koorparatës për të përvetësuar atë iks pronë që koorparatës pa prituri duket e leverdishme?

Elton Haxhi- Në projektligj ka një nen që thotë që rregullat dhe përcaktimet në lidhje me transferimin e pronës do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe aty do të përcaktohen të gjitha rregullat e transferimit të pronës.

Ministria gjatë kësaj periudhe është angazhuar edhe në një *due diligence* të pronave shtetërore bazuar në disa kriteret e caktuara për të bërë një vlerësim se kush do të ishin pronat fillestare të pikëzuara sipas prioriteteve dhe sipas fizibilitetit të tyre që mund të

kalonin si kontribut në natyrë për krijimin e koorparatës. Bazuar në ato kritere, ne kemi bërë një vlerësim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Zonja Edlira, flitet me leje.

Zoti Haxhi, pyetja ishte më specifike, edhe përgjigjja duhej të ishte më specifike.

Nëse autoriteti lokal refuzon, çfarë ndodh? Përgjigjja në frymë të ligjit dhe në nen të ligjit, por edhe në ligjet e tjera të trajtimit të pronës është që AIC-ja mund të hyjë me njësinë vendore, me bashkinë në partneritet.

Së dyti, në bazë të ligjit të pushtetit vendor kompensohet bashkia për pronën që jep.

Së treti, duhet ta thuash që nuk është shpend grabitqar, por prona transferohet si... Kjo normalisht bëhet në bazë të procedurave ligjore dhe bëhet fjalë për prona që atje janë të pazhvilluara. Nuk bëhet fjalë që do të shkojë të marrë një pronë që po e zhvillon në një mënyrë a në një tjetër bashkia ose pushteti qendror. Këto përgjigje qartësojnë të gjithë qëllimin dhe funksionin e AIC-së (e agjencisë, e korporatës). Pra, pyetja ishte e drejtë.

Unë e kuptoj shumë mirë që ju i referoheni inventarit të pronave, të cilat janë, le të themi, të fjetura, të pazhvilluara, të pafrytshme ose, gjithashtu, me potencë, por të pazhvilluara që, nëpërmjet AIC-së dhe partneriteteve të ndryshme qoftë me privatin, qoftë me donatorët, të zhvillohen dhe të kthehen në projekte frytdhënëse dhe në favor të zhvillimit ekonomik.

Por pyetja ishte specifike dhe ashtu duhet të jetë edhe përgjigjja.

Po, zonja Edlira.

Edlira Hyseni – Faleminderit!

Po bëj një pyetje, që është ndër më të parat, në fakt, që duhet të bëjmë kur themi se në nenin 5 përcaktohen funksionet e korporatës dhe funksioni kryesor i saj është zhvillimi dhe menaxhimi i pronave shtetërore. A nuk është ky një funksion i shtetit, në fakt? Pra, nëse lind kjo domosdoshmëri, ne jemi duke pranuar që qeveria, shteti, ka qenë i pasuksesshëm në menaxhimin e pronave shtetërore?

Në Shqipëri ka një realitet ku të gjithë janë të zhgënjyer për nga mënyra sesi janë menaxhuar asetet strategjike ose pasuritë shtetërore. Tani, krijimi i kësaj korporate është në njëfarë mënyre pranim që shteti nuk ia del, nuk ka funksionuar gjithë këto vite dhe vazhdon të mos jetë i aftë të menaxhojë pronat shtetërore, asetet e saj, dhe ia delegon këtë një korporate?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qeveria.

Jo, po pyes! Ky është subjekt privat, ndërsa shteti është... Ky do të jetë një subjekt privat, do t'i nënshtrohet ligjit të shoqërive tregtare me qëllime fitimprurëse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk funksionon për beneficencë!

Arben Ahmetaj – Më falni!

Edlira Hyseni – Pra, kjo nevojë lind...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duket si një shtet paralel brenda...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ju lutem, zoti Angjeli!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Hyseni – Ky është subjekt privat.

Arben Ahmetaj – Zonja Edlira, patjetër që zoti Haxhi do t'ju përgjigjet, por një përgjigje po jua jap edhe unë, si kryetar i komisionit: logjika e shtetit është dinamike dhe, në qoftë se ju, si deputetë opozite, kërkonit të vijë këtu zëvendësministri ose ministrja të thotë: “Po, kemi dështuar dhe po krijojmë një institucion të ri”, kjo nuk është e vërtetë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse zhvillimi ekonomik prej 4,2%, 4,06% tregon krahasimisht se kush ka dështuar dhe kush jo. Por logjika...

Gjithsesi, është ditë e parë e shkollës dhe u urojmë të gjithë nxënësve dhe atyre, që kanë qejf të festojnë në këtë ditë, një ditë të mbarë, por besoj se komisioni nuk duhet të bëjë pyetje provokative ndaj qeverisë: ka dështuar ose jo qeveria.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, qeveria nuk ka dështuar, përkundrazi, edhe pyetja “Kush e ka?”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Roshi! Ju lutem, zoti Angjeli, mos debatoni!

Edhe pyetja: “Kush e ka?”... Për shembull, në Gjermani ka institucione të cilat ne nuk i kemi; në Francë ka institucione që Gjermania nuk i ka; në Shqipëri...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Korporata ka e gjithë bota.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, mos më ndërhyjni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë jam kryetari. E keni lexuar Rregulloren e Kuvendit? Ah, nëse të renë nuk e keni lexuar, atëherë avantazhi im i vetëm është ky që po bëj tani, se avantazh tjetër nuk kam, votën e kemi të barabartë! Kështu që, lexojeni Rregulloren dhe m'u referoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, jo vetëm që shteti nuk ka dështuar, por, përkundrazi, po që se shikoni inventarin e pronave, se jeni njerëz me eksperiencë edhe majtas, edhe djathtas, deri në vitin 2018 pronat janë të gjitha strategjike dhe jostrategjike. Gati 90% e tyre janë privatizuar dhe janë zhbërë.

Flasim për një inventar pronash publike të lëna për shkak të pozicionit, për shkak të mundësisë financiare, për shkak të kërkesave të munguara, për shkak të pafrytshmërisë, të konjektivitetit të munguar e të tjera...

Në të gjithë botën ka institucione urë. Si ia vendosin emrin? Njëri ia vë “korporatë”, tjetri ia vë “agjenci”. Patjetër që në profil dhe në funksion e gjithë bota ka entitete të ngjashme.

Vazhdojeni pyetjen. Gjithsesi, dita e parë e shkollës është. Kështu që...

Edlira Hyseni – Jo, ndoshta dita e parë e shkollës...

Arben Ahmetaj – T’i urojmë studentët, nxënësit, të gjithë, se i harruam në momentin e parë...

Edlira Hyseni – Zoti kryetar...

Arben Ahmetaj – ...megjithëse ishim nëpër zona: një vit të mbarë akademik!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Hyseni – Edhe unë ua uroj vitin shkollor të gjithëve vërtet, por nuk besoj se e kishit për nxënësit. Ndoshta më referoheni mua si ditë e parë e shkollës, që duhet të mësoj ende?!

Arben Ahmetaj – Ju, zonjë, e keni mbaruar shkollën! Nuk është ky debati tani!

Edlira Hyseni – Kam mbaruar disa, jo një. Megjithatë...

Arben Ahmetaj – Edhe për vete i kemi mbaruar disa. Edhe unë kam mbaruar disa për vete, po ashtu zoti Angjeli; të gjithë për vete i mbarojnë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Hyseni – Në rregull. Mund të vazhdojmë, ju lutem?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Një tjetër pyetje që kam është: sipas parashikimeve të ligjit që ju propozoni, ndër ortakët ose aksionarët e kësaj shoqërie, që do të jetë një “sh.a” (shoqëri aksionare), është

shteti, domethënë qeveria përfaqësohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe kanë të drejtë, - thoni ju, të jenë aksionere edhe institucione të ndryshme financiare ndërkombëtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I kemi të qartë këta dy aksionarë. Pyetja ime është: a do të kenë të drejtë dhe mundësi, si dhe a është e parashikuar ose e lejuar që aksionarët e tjerë të jenë edhe subjekte tregtare private shqiptare, apo individë, oligarkë, apo ku e di unë, emra të famshëm për të cilët flitet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, kryetari e mbron me të drejtë këtë projektligj, por duhet të themi se nga debati i fortë, që është ngritur për këtë projektligj, lindin këto dyshime që ndoshta këtu në komision mund të ndihmojmë që të sqarohen. Prandaj, nuk besoj se ka ndonjë problem nga debati.

Ky ligj ka krijuar në opinionin publik perceptimin si një diçka e re që po sjell një përqendrim të pushtetit të ri, meqenëse akuzoheni se po merrni të gjitha pushtetet. Kjo duket si marrja e një pushteti të ri ekonomik, ndaj është mirë që ta sqarojmë. Prandaj, pyetja ime lidhet konkretisht me aksionerët e kësaj korporate. Pra, përveç Ministrisë së Ekonomisë dhe institucioneve ndërkombëtare, a parashikohet që të jenë edhe operatorë të thjeshtë në këtë korporatë, si subjekte, individë, tregtarë e të tjerë?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zoti Haxhi.

Elton Haxhi – Po përgjigjem shkurt: këta operatorë nuk parashikohen në projektligj! Në projektligj parashikohet që qeveria mund të gjykojë përshtatshmërinë e shitjes së aksioneve, zgjerimin e kapitalit e të tjera nëpërmjet institucioneve financiare ndërkombëtare të zhvillimit.

Arben Ahmetaj – Ai u përgjigj!

A keni pyetje të tjera?

Edlira Hyseni – Përgjigjja ishte që në projektligj parashikohen vetëm institucionet financiare ndërkombëtare, ndërsa të tjerët nuk kanë të drejtë. Kjo ishte përgjigjja? Në rregull!

(Diskutime pa mikrofon)

Unë i kam diskutime të përgjithshme dhe nuk do të flas më kur të shkojmë nën për nen.

Në ligj parashikohet që detyrimet e korporatës nuk do të pasqyrohen, ndaj do t'i mbeten vetëm korporatës. Pra, këto detyrime nuk do të pasqyrohen dhe nuk do të mbarten në buxhetin e shtetit. Tani, ne jemi në kohën e miratimit të disa kontratave të reja, PPP-ve, dhe një nga debatet e ngritura në opinionin publik është kontabilizimi i këtyre detyrimeve në bilancet e shtetit apo në borxhin publik. A duhen bërë këto transparente? A janë këto

detyrime të fshehura? Me sa kuptohet, aktiviteti i korporatës do të jetë një vijimësi e investimeve pak shumë në format e PPP-ve apo të mënyrave të tjera të bashkëfinancimit ndërmjet shtetit dhe privatit. Mosnjohja, mospublikimi, mungesa e transparencës apo e informacionit lidhur me këto detyrime të korporatës, a nuk lenë vend për të vijuar përsëri debatin nëse kjo është e drejtë? A ka rrezikshmëri kjo gjë?

Së dyti, për shembull, çfarë ndodh nëse kjo korporatë do të falimentonte, sepse subjekt privat është dhe ekziston rreziku për falimentim si çdo biznes? Si ta kuptojmë ne, që po falimenton shteti? Si është parashikuar të menaxhohet një eventualitet i tillë?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Më falni, zoti Haxhi!

Edhe një herë: kjo korporatë nuk do të funksionojë me ligjin e saj, pra me ligjin specifik. Pyetja juaj: nëse falimenton korporata, a falimenton shteti, më duket ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo nuk më duket tendencioze, më duket më shumë se aq, sepse, në qoftë se falimenton një kompani me kapital shtetëror, por me të drejtë private (këtu jam duke folur teknikisht) dhe, në qoftë se nuk ka garanci shtetërore, buxheti i shtetit nuk ka asnjë detyrim. Tani, këto janë gjëra ne i dimë që ditën e parë. Për çfarë e bëjmë këtë gjë? E bëjmë për publikun! Ne këtu jemi duke folur në parim dhe kërkojmë racionalitet. Pra, të thuash që nëse falimenton korporata, falimenton edhe shteti, besoj se nuk shkon në seriozitetin e këtij komisioni. Ky komision ka një traditë, të paktën në njohurinë time shumëvjeçare që në kohën kur e drejtonte zotit Angjeli, por edhe më shumë vite më parë. Patjetër që do të ketë debate, patjetër që do të ketë mendime të kundërta, patjetër që do të ketë edhe zënka, por pyetje të kësaj natyre, për këtë lloj falimentimi, kam përshtypjen se nuk janë në seriozitetin e këtij komisioni.

Nëse e keni vënë re, ka projekte që specifikisht garantohen nga buxheti i shtetit, për shembull me KESH-in, me OSHEE-në, me OST-në, ndonjëherë edhe me portin e Durrësit, ndërsa pjesa tjetër nuk futet fare në garanci kur ka ...

(Diskutime pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Një minutë, ju lutem!

Ky është një ligj i ri, që vjen me koncepte të reja nga një institucion i ri, ndaj është e natyrshme që do të ketë pyetje, debate dhe sqarime.

Unë dua të trajtoj vetëm dy çështje, në mënyrë që të mos keqkuptohemi.

Çështja e parë lidhet me atë që u diskutua nëse falimenton apo jo shteti, i cili e drejton këtë shërbim në një agjenci. Unë nuk besoj se kjo lidhet me të dytën. Nga vetë zhvillimi i ekonomisë së tregut dhe nga përvoja që ju keni për të bërë këtë pyetje, pavarësisht se ishte

shumë larg nga shtetet Europës që përmendët, tregohet se në kohë të ndryshme, për funksione të ndryshme, krijohen institucione dhe agjenci të ndryshme të varura dhe të pavarura. Ne jemi me teorinë për sa më pak shtet, kështu që është mirë që të krijohen këto institucione. Qëllimi nuk është se çfarë institucioni krijohet dhe si e ka emrin, qëllimi është çfarë do të bëjë ky institucion. Pra, se çfarë do të bëjë ky institucion ne do ta sqarojmë në mbledhjen e ardhshme, kur të diskutojmë nën për nen.

Çështja e dytë ka të bëjë me pyetjen: a falimenton shtetit, kur falimenton një kompani?! Koncepti i falimentimit të shtetit nuk ka të bëjë dhe nuk lidhet fare me asnjë kompani, nëse një del me fitim dhe një me humbje, nëse njëra mbyllet dhe tjetra hapet, por ka të bëjë tërësisht me një koncept tjetër se kur një shtet falimenton financiarisht. Pra, më vjen keq, ky rast nuk ka lidhje fare me shtetin. Ju mund t'i shikoni eksperiencat e disa shteteve se në cilat raste dhe përse ato kanë shpallur falimentin.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Po, zonja Mesi.

Senida Mesi – Doja një sqarim ndoshta në këtë kuadër...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Kërkojeni fjalën dhe patjetër që mund të flisni, por jemi duke diskutuar në parim. Zonja Edlira u fut në detajet e neneve dhe unë nuk doja ta ndërprisja, meqenëse është ankuar, por kjo nuk ka rëndësi.

Ju lutem, duhet të merremi me parimet e konceptit.

Senida Mesi – Zoti kryetar, në parim dua të bëj një sqarim të shkurtër që lidhet me pyetjet e mia të mëparshme, të cilat sqaronin një element të rëndësishëm, që ne nuk po bëjmë shtet nga zeroja dhe nuk po fillon çdo gjë nga zeroja, por është e kundërta në rastin konkret. Ky ligj sjell si risi identifikimin e problematikave ekzistuese të shumë pronave shtetërore, të cilat janë aty dhe nuk i sjellin asnjë lek buxhetit të shtetit, përkundrazi, buxheti i shtetit harxhon lekë për t'i mirëmbajtur, ruajtur e të tjera.

Duke kuptuar që ka shumë projekte dhe ide, ne duam që sot këto struktura të shtetit të ndihmojnë dhe të suportojnë në një agjenci apo një korporatë, e cila operon si çdo privat tjetër. Nëse kjo agjenci, apo korporatë, me trokitjen në dyert e investorëve, i kthehen ato ide në projekte të financueshme 100%, atëherë ky është suksesi i kësaj korporate. Këtë duhet të sigurojmë ne si komision, me qëllim që të gjitha institucionet e tjera në Republikën e Shqipërisë të jenë jo thjesht në funksion të lejeve, të ecurisë së mbarë dhe monitorimit të kësaj korporate, por edhe që të kuptojmë se këto prona shtetërore dhe publike të shfrytëzohen me eficiencë të plotë.

Kjo korporatë këtë ka si qëllim që nesër projektin “Det” apo projektet e tjera të merren nga bankat në Republikën e Shqipërisë apo investitorë të huaj dhe të financohen menjëherë. Pra, është kjo risi për t’i kthyer më tepër në eficiencë.

Edhe një sqarim tjetër të vogël. Në gjykimin tim si ekonomiste, shteti po heq dorë nga autoriteti i tij për t’ia lënë një korporatë, e cila të maksimizojë dhe të rrisë eficiencën. Kjo korporatë nesër do të fillojë me një fond dhe do të përfundojë me një...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Risia është se shteti nuk po delegon funksione, përkundrazi, si korporatë dhe menaxhohet ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjatë shqyrtimit nen për nen ne mund ta sqarojmë më mirë dhe mund të bëjmë sugjerimet tona për ta maksimizuar dhe për të rritur eficiencën, por duhet të kuptoni thelbin e këtij projektligji.

Nëse projektet sot rrijnë nëpër sirtarë apo investitori i huaj nuk e ka të mundur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, unë e shikoj këtë korporatë si një avokat të çdo investitori me qëllim që për 15 apo 30 ditë ai projekt të bëhet i tregtueshëm. Ne si komision a jemi në gjendje që ta kthejmë këtë projektligj në eficiencën maksimale? E bëjmë kur ta trajtojmë nen për nen.

Në kuadër të sqarimit të opinionit publik, unë e pashë të arsyeshme që kjo të bëhet e qartë edhe me institucionet e tjera, se ku është ndërlidhja dhe pse është i rëndësishëm themelimi i kësaj korporate.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Duhet të keni parasysh se do ta kalojmë edhe nen për nen dhe do të keni mundësi t’i përsërisni të gjitha këto. Shteti vepron edhe si autoritet rregullator, edhe si autoritet ekonomik ekzekutiv. Kur funksionon si autoritet ekonomik, pra me kapital shtetëror me të drejtë private, pra nëpërmjet një korporate zbaton të gjitha ligjet në fushën e ushtrimit të aktivitetit privat, si të gjithë aktorët ekonomik, sikur të ishte një individ apo një kompani. Pra, mos i miksoni konceptet: qeveria si rregullatore në bazë të Kushtetutës dhe shteti nëpërmjet instrumenteve si aktor ekonomik. Ky është një instrument që qeveria ka vendosur ta përdor si urë.

Unë e kuptoj edhe paragjykimin, sepse ju vini si opozitë dhe keni dëgjuar e lexuar debatin, i cili ka qenë i pabazuar në nenet e draftligjit, gjithsesi do t’ju lutesha që të jemi

racionalë, të fokusohemi te parimi e funksionet dhe të mos paragjykojmë një entitet, i cili ka pasur sukses në shumë vende.

Pra, thelbi është që qeveria po ngre një instrument, i cili mund ta bëjë më efektiv, më të shpejtë, më fitimprurës dhe më pak burokratik marrëdhënien me donatorët, pra me privatin për projekte të ndryshme, bazuar në prona, siç iu referua saktë Senida, janë të pazhvilluara për ato arsye që u përmendën, të cilat sot kanë një mundësi që të zhvillohen nëpërmjet AIC-së. Por përsëri nuk është ky thelbi i funksionit. Po të lexoni, thelbi është ura për një projekt mes donatorëve dhe qeverisë, i cili ka nevojë që të ketë një instrument që të veprojë shumë më shpejt, siç vepron në jetën e përditshme ekonomike një entitet privat.

Më besoni, nuk është risi, emri mund të jetë risi, ndërsa funksionet janë shumë standarde. Në të gjithë botën e qytetëruar, për shembull, nëse ju e quani Meksikën apo Kilin si botë e tretë, duhet ta dini se sot po kërkojnë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përse i paragjykoni Jordaninë, Kanadanë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse i paragjykoni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cili është shembulli? Kanadaja nuk është? Meksika nuk është? Kili nuk është? Institucione në Europë që janë të ngjashme, që nuk quhen korporata, kanë të drejtën ta bëjnë zhvillimin e pronës publike në logjikën e së drejtës private, megjithëse janë me kapital shtetëror dhe janë terma teknike, pra e drejta private me kapital shtetëror. Ai vepron në bazë të së drejtës private, e krijuar pra në bazë të kësaj të fundit, por kapitalin e ka shtetëror, siç mund ta kishte...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka pasur dhe ka funksione të kësaj natyre në të gjithë botën e qytetëruar. Ndaj, ju ftoj, si profesionistë, të mos i paragjykoni, sepse është paragjykim i kotë, apriori!

U bë *unbundling* ndarja e KESH-it atëherë: e mbaj mend diskutimin. Ishte një diskutim qesharak, paragjykim komplet, që doli se ishte një kërkesë e Bashkimit European, në bazë të direktivës e të tjera.

U bë pjesa tjetër e OSHEE-së? E njëjta gjë. Tani del se është gjëja e duhur për t'u bërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjithsesi, do t'ju lutesha, si profesionistë, pastaj si opozitarë, bëni çfarë të doni, por mos i paragjykoni institucionet. Shikoni funksionet. Në qoftë se keni opinione për t'i

përmirësuar, për t'i qartësuar, do të jenë vlerë qoftë për draftligjin, qoftë për punën e qeverisë, por edhe për këtë komision.

Ky komision, e theksova, ka traditë serioziteti të vazhdueshme. U bënë 28 vjet, të paktën në kujtesën time që kur kam ardhur edhe si ministër, edhe si ndihmës i ministrit dikur, që ka seriozitet qoftë në pyetje, qoftë në debat. Pra, nuk ka devijuar nga serioziteti. Mund të ketë pasur sherre, patjetër edhe sherre të shëmtuara, por në aspektin e seriozitetit dhe të profesionalizmit nuk ka çeduar kurrë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ia bëni si pyetje zotit Haxhi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mua?! Mua mos më bëj pyetje, se nuk jam këtu për t'iu përgjigjur pyetjeve të tua, por për të dhënë opinionet e mia! Madje, ju kërkova profesionalisht, miqësisht e politikisht që ta mbajmë serioz të gjithë debatin dhe pyetjet.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Dua të di, do të bëjmë vetëm pyetje, apo mund ta marrim fjalën edhe për diskutime, siç po bëjnë të gjithë? Dhe pastaj të nxjerr pyetjet në fund.

Arben Ahmetaj – Shikoni...

Vullnet Sinaj – Të jap opinione dhe të nxjerr pyetjet në fund, apo të bëj vetëm pyetjet?

Arben Ahmetaj – Ti je lejohesh t'i bësh të dyja si të duash.

Vullnet Sinaj – Faleminderit!

E para, kërkoj ndjesë për këtë mungesë modestie që do të tregoj. Për një periudhë kohe isha me një mikun tim, i cili, teksa bisedonim, më kërkoi një ide, e cila mendoj se ngjan shumë me idenë që ka ardhur sot nga qeveria. Por kësaj ideje i mungon vetëm diçka. Tani unë do t'ju shpjegoj se si e kam pasur idenë, por që përputhet me idenë që ka sjellë ministria. Nëse është e njëjta apo janë të ndryshme, kjo është tjetër gjë.

Në kontaktet me njerëzit në terren, sidomos me fermerët në zonat e fshatrave rurale, pashë që kishin probleme të jashtëzakonshme me eksportin e produkteve të tyre të perimeve dhe frutave. Vija re se asnjë subjekt privat nuk e merrte iniciativën për ta bërë një gjë të tillë, pasi duhej një investim shumë i madh: për frigoriferë, për magazina. Nga ana tjetër, edhe sikur të bëhej ky investim për frigoriferë dhe magazina, duhej një ndërhyrje në tregun e

jashtëm. Unë mendoja që Ministria e Bujqësisë ose shteti, në rast se do të bënte një partneritet me një kompani të përbashkët shtet-privat, do t'i jepte mundësinë këtij privati që ta ngrinte këtë kompani, duke ndihmuar kështu eksportin e këtyre produkteve. Por te pjesa e idesë sime ka qenë që më mbrapa kjo kompani të privatizohej, të mos ngelej në dorë të shtetit. Por kjo gjë mungonte në ligj. Pra, mendoj se ideja ka mbetur përgjysmë.

Një arsye tjetër, për shembull, kisha informacion për një fabrikë ose uzinë që është në Pashaliman, të cilën e kanë ndërtuar holandezët, por ata janë larguar dhe e kanë lënë atje. Ajo uzinë mund të prodhojë dhe të riparojë anije, madje është shumë e rëndësishme për ekonominë. Në rast se do të privatizohej, do ta merrte një privat dhe do ta bënte hotel, nuk do ta linte uzinë. Ndaj më lindi ideja: pse shteti vetë të mos ndikojë në gjëra të tilla dhe ta vendosë ashtu siç duhet, bashkë me një privat?

Tjetër, keni të gjithë historinë e të gjitha privatizimeve që janë bërë në vendin tonë deri tani. Kemi dalë nga objekti dhe jemi kthyer në një shtet që importojmë shumë më tepër sesa eksportojmë. Rezultati i importeve të mëdha, që bëjmë në krahasim me eksportet, ka ardhur edhe si rezultat i privatizimit të gabuar të kompanive që janë krijuar, të cilat kanë ndryshuar qëllimin. Këto gabime janë bërë që në kohën tuaj e me radhë, që në kohën e Saliut, por ka edhe objekte që nuk po i privatizon njeri. Pse të mos vendosë dorë shteti në disa privatizime të tilla ose kompani që t'u japë atyre drejtimin e duhur për ekonominë e këtij vendi?

Të gjithë i kemi dëgjuar ngjarjet, ta zëmë, edhe grabitjen në aeroport të parave që dalin nga Shqipëria. Pra, dalja e parave nga Shqipëria është rezultat i këtij raporti të keq që ka importi me eksportin në Shqipëri. Pra, duhet ta nxisim prodhimin vendas.

Mos harroni! Vetë biznesi shqiptar ka vetëm 30 vjet në ekonominë e tregut dhe është biznesi më i ri privat ose kapitalizmi më i ri i Ballkanit, jo më i Europës, pasi Europa i ka shumë më të fuqishme.

Arben Ahmetaj – Zoti Vullnet, ju lutem!

Vullnet Sinaj – Do të mendoja që vetë biznesi privat...

Ju lutem, se po shkoj drejt fundit!

Arben Ahmetaj – Ju lutem, fokusohuni!

Vullnet Sinaj – Vetë biznesi privat kishte nevojë për mbështetjen e shtetit për të ndërtuar një korporatë ose disa kompani të tjera në bashkëpunim me shtetin për t'i ngritur këto biznese në atë pikë që pastaj të privatizohen.

Pyetjet e mia janë: çfarë parashikon ky ligj për të mbrojtur biznesin privat nga kjo korporatë, pasi kjo mund ta konkurrojë biznesin privat? Në rast se kjo korporatë futet në

fushën ku operojnë disa biznese private, si do të mbrohen këto të fundit nga ligji? Prandaj unë kam pasur idenë se korporatat e ndryshme ose kompanitë e ndryshme të ishin bashkortake me pararojën e biznesit në këtë fushë dhe më pas të privatizohen, pra të mos ngelen shtet këto korporata. Por edhe të gjitha diskutimet që dëgjoj këtu vijnë rreth kësaj pike.

Këto kanë qenë idetë e mia dhe unë dua përgjigje vetëm për këtë gjë, si do të mbrohet biznesi privat? Cila do të jetë e ardhmja e kësaj korporate shtetërore, do të kalojë të privatizohet apo do të ngelet gjithmonë në duart e shtetit?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Sinaj!

Zoti Haxhi, fjala është për ju, por, ju lutem, sa më shkurt përgjigjen!

Elton Haxhi - Atëherë, në lidhje me privatizimin në të ardhmen të kësaj korporate, kjo nuk është një strategji që përcaktohen në projektligj, por është një strategji që e vendosin në të ardhmen organet drejtuese të korporatës. Për më tepër, është lënë hapësira, që qeveria të vlerësojë nëse do t'i shesë një pjesë të aksioneve të korporatës tek institucionet ndërkombëtare financiare të zhvillimit. Kjo hapësirë është lënë.

Në lidhje me privatizimin tërësisht të korporatës, kjo nuk është një vendimmarrje që duhet përcaktuar në projektligj.

Në lidhje me konkurrencën, duhet të kemi parasysh që korporata nuk do të hyjë në prona, të cilat ju i përmendët më parë. Bëhet fjalë për pronarë që kanë një kompleksitet dhe kanë një rëndësi strategjike. Do të hyjë në 5 projekte të rëndësishme, të cilat për momentin nuk është bërë e mundur që të përdoren në forma të tjera. Këtu u përmend që shteti ka mekanizma dhe mund të funksiononte gjatë kësaj periudhe. Duhet të kemi parasysh që prona publike me legjislacionin aktual ose shitet në ankand, ose jepet me qira, ose jepet për investime strategjike me 1 euro dhe shteti humbet të gjithë angazhimin, pas këtyre veprimeve që sapo thashë. Ky projektligj, kjo strukturë, bën të mundur që shteti nëpërmjet kësaj korporate, nëpërmjet tërheqjes së ekspertizës së huaj në këtë korporatë të maksimizojë përdorimin e këtyre aseteve të rëndësishme. Pa këtë korporatë do të ishte e pamundur që një investitor privat të hynte dhe të zhvillonte një projekt të këtij kompleksiteti, të cilin korporata mundohet që ta adresojë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artur Roshi - Faleminderit, zoti Ahmetaj!

Zoti Haxhi, unë i kam pyetjet të koncentruara, prandaj dua vetëm përgjigje shkurt, që të mos rrimë të bëjmë interpretime pa vlerë.

Së pari, a do të ketë privat që do të japë oferta të pakërkkuara, siç thuhet në relacionin mbështetës të projektligjit, pra se do të ketë bashkëzhvillues të investimit në prona shtetërore korporatë-privat? E dua përgjigjen vetëm me një fjalë.

Elton Haxhi – Oferta e pakërkkuar nuk ka lidhje me korporatën. Korporata do të vlerësojë projektet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, duhet të jetë tjetër.

Artur Roshi – Në çfarë forme do të investojë kjo korporatë në pronat private? Te neni 7, germa “ç” ...

Arben Ahmetaj – Ju lutem, mos u fusni në nene, sepse do të kemi mundësi nen për nen!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni, zoti Haxhi!

Elton Haxhi – Po marr një shembull të thjeshtë për ta bërë më të kuptueshme për publikun. Shteti do të transferojë disa prona si kapital fillestar të kësaj korporate. Do të bëhet një studim për zhvillimin e kësaj prone me ekspertizë të huaj dhe vendase. Ky projekt mund të ketë nevojë për financim. Financimi do të sigurohet qoftë nga institucionet ndërkombëtare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, është pronë e korporatës. Në momentin kur shteti transferon pronën si kapital fillestar i korporatës, është pronë e korporatës.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

A keni pyetje tjetër, zoti Roshi?

Artur Roshi – Kam disa pyetje, por i dua përgjigjet shkurt.

Kreditë që ka të drejtë të marrë korporata, çfarë natyre do të kenë? Si do të jenë ato afatshkurtra, afatmesme apo afatgjata? Marrja e kredisë mos na sjell ndonjë model ose ndonjë trajtë tjetër, që nuk ndryshon në formë shumë nga PPP-të? Cili është gjykimi juaj?

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, zoti Haxhi!

Elton Haxhi – Marrja e kredive do të vlerësohet gjatë studimit dhe gjatë hartimit të studimit të fizibilitetit. Pra, sa do të jetë kredia që do të kërkohet dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Më fal, banka nuk të jep 100 vjet, në qoftë se ti nuk ke projekt-*bankable* dhe nuk i ke raportet e kapitalit me kredinë, raportet e kolateralit me kredinë,

raportet e kthimit të investimit, raportet e të ardhurave me kredinë, pra janë elemente financiare, që dihen shumë qartë, për të marrë kredi.

Artur Roshi – Zoti Ahmetaj, unë ia drejtova pyetjen zëvendësministrit dhe nuk e di si ka ndryshuar kjo rregullorja e fundit.

Arben Ahmetaj – E kam këtë avantazh, zoti Roshi, nuk keni çfarë të bëni. **Artur Roshi** – Jo, unë ia drejtova atij pyetjen.

Arben Ahmetaj – E kam këtë avantazh.

Artur Roshi – Jo, të përgjigjeni ju. Pse e thirrëm atë këtu?! Më lind pyetja: pse vjen zëvendësministri?!

Arben Ahmetaj – Nuk po përgjigjem, po mbaj qëndrim.

Artur Roshi – Mbajeni në fund qëndrimin.

Arben Ahmetaj – E kam këtë avantazh, ta mbaj sa herë flas.

Artur Roshi – Po pse është zëvendësministri? Le të ikë dhe ne bëjmë bashkë debat?!

Arben Ahmetaj – Po edhe këtë do ta bëjmë ndonjë ditë.

Artur Roshi – Dakord, zoti Zëvendësministër?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përgjigjja është se nuk e ke idenë.

Çfarë kupton ti me institucione financiare ndërkombëtare?! A quhet i tillë, për shembull, fondi i investitorëve shqiptaro-amerikanë në Amerikë?

Elton Haxhi – Jo, nuk jam në gjendje t'i përgjigjem, sepse nuk e di se çfarë statusi ka ky fondi.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

A ke pyetje tjetër?

Artur Roshi – Ti je i ftuar këtu dhe duhej ta kishe idenë, sepse je zëvendësministër Ekonomie, por ne jse nuk ka rëndësi.

Si harton dhe zbaton projekte nëpërmjet sipërmarrjes private apo mund të ketë brenda vetes sektorë hartimi projektesh dhe zbatimi, njerëz të punësuar nga vetë korporata?

Elton Haxhi – Atëherë, një model mund të ishte krijimi i SPV-ve apo i ndërmarrjeve me qëllim specifik. Pra, korporata për një projekt të caktuar mund të krijojë një bijë, nëse mund ta themi shqip, dhe nuk diskutohet që bija do të ketë të gjitha funksionet e menaxhimit të projektit...

Arben Ahmetaj – Ose mund të ketë departament brenda, departamentin e hartimit të projekteve, siç e ka KESH-i, OSHE-ja, OST-ja, ALBPETROL-i e të tjerë, pasi mund të

kontraktojë grupe specialistësh që mund të bëjnë, kundrejt rregullave, kundrejt pagesës dhe kundrejt ligjeve, projekte për korporatën.

Artur Roshi- A mund të marrë pjesë korporata në gara, në tendera të ndryshëm publikë që zhvillohen nga institucione të tjera shtetërore, pjesë e një kompanie sipërmarrëse?

Elton Haxhi – Nuk ka ndonjë përkufizim në projektligj, kështu që nuk besoj se e ka të ndaluar të marrë pjesë, përveç sigurimit...

Arben Ahmetaj- Pyetja ishte për tenderat publikë.

Elton Haxhi –Ka një nen në projektligj, i cili siguron në lidhje me respektimin e legjislacionit për ndihmën shtetërore.

Arben Ahmetaj – Pra, në tendera publikë korporata nuk hyn dot. Jemi duke folur për projekte dhe jo për tenderime. Pra, jemi duke folur për projekte, të cilat kanë elemente strategjike dhe jo projekte për të ndërtuar rrugë apo ujësjellës.

A isha i qartë në përgjigjen time, zoti Roshi?

Artur Roshi- Ju jeni i qartë, por nuk është i qartë ai dhe kam rezerva për këtë.

Cila është pavarësia në vendimmarrje e korporatës? Si e kuptoni ju këtë pavarësi?

Elton Haxhi – (**mungesë dëgjimi**) ... neni 13, ku përcaktohet numri, jo më pak se 5, i këshillit mbikëqyrës, ku shumica janë të pavarur.

Arben Ahmetaj- Faleminderit!

Pra, vendimmarrja është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elton Haxhi – Ka shumë lidhje.

Arben Ahmetaj – Zoti Roshi, si rregull mund të mos ju pëlqejë përgjigjja dhe do të bëni komente, por ju lutem, mos bëni debat për përmbajtjen e përgjigjes së zëvendësministrit, sepse ajo është përgjigjja zyrtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptoi ai, prandaj iu referua nenit 13. Ju lutem, zoti Haxhi, mos iu referoni neneve, sepse do të kalojmë nen për nen! Parimi është që në bazë të funksionimit dhe rregullave të brendshme është e pavarur si entitet me të drejtë private, sot është me kapital shtetëror, por nesër mund të ketë kapital të përbërë, për shembull, me një institucion ndërkombëtar, BERZH-i mund të bëhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artur Roshi- Sepse bëhet një PPP tjetër.

Të rimë te pyetja, kur të kalojmë te komentet jam dakord.

Si do ta respektojë kjo korporatë parimin e konkurrencës së lirë në treg?

Arben Ahmetaj- Zoti Haxhi, me lejen tuaj, a mund t'i përgjigjem unë kësaj pyetjeje?
(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Haxhi, ka ligje. Pyetja e zotit Roshi është e saktë, por provokuese, sepse ligjet sot ndalojnë konfliktin e interesit, jo vetëm të individëve, por edhe të entiteteve dhe ka ligje, paketa ligjore, të cilat garantojnë respektimin e konkurrencës në treg. Ndihma shtetërore është një nga elementet që pengon AEC-në të ketë dominancë dhe avancë në lidhje me subjektet e tjera.

Elton Haxhi- Për më tepër, ky ka qenë edhe një nga komentet e Komisionit European, i cili është saktësuar në...

Arben Ahmetaj- Faleminderit!

Je shumë i saktë.

Artur Roshi – Pyetja e fundit. Në çfarë mënyre mund të mbart përgjegjësi në zhvillimin e politikave sociale kjo korporatë?

Elton Haxhi – Pyetja është e saktë, por nuk jam unë që i përgjigjem, është Këshilli Mbikëqyrës i Korporatës dhe këshilli këshillimor që do të vendosin për miratimin e projekteve, të cilat do të vendosin për miratimin e projekteve që do të kontribuojnë në zhvillimin social, punësim dhe zhvillim ekonomik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka të përcaktuar në projektligj tek objekti i saj që korporata do të fokusohet në këto projekte dhe rrjedhimisht këshilli mbikëqyrës do të orientohet sipas këtij parimi.

Arben Ahmetaj- Kur të kalojë ligji kjo korporatë do të funksionojë në bazë të të gjitha ligjeve dhe frymës. Besoj se ju jeni të mirinformuar për konceptin, që tashmë nuk është i ri, por ka filluar të konsolidohet në të gjitha korporatat në Shqipëri, pasi në botën e qytetëruar ka shumë kohë, që është përgjegjësia sociale e korporatave dhe, patjetër, që në frymën e çdo entiteti publik apo jopublik ekziston, tani pjesë e statutit dhe pjesë e frymës.

Pyetja juaj është e saktë, sigurisht që në detajimin e funksioneve dhe të veprimtarisë Këshilli Mbikëqyrës do të jetë në gjendje të vendosë edhe specifika për sa i përket përgjegjshmërisë sociale korporative të AIC-ës.

Atëherë vijojmë me opinionet, por shkurt, ju lutem!

Vullent Sinaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam një pyetje për Zëvendësministrin: në çfarë forme vepron korporata edhe në ekonominë private, pra në pronat private?

Arben Ahmetaj – Është pyetje e përsëritur, por nuk ka gjë.

Vullnet Sinaj – A ka të drejtë korporata të shesë pronat e ndryshme për arsye të ndryshme. Po jua bëj resht pyetjet, pastaj përgjigjuni si të doni.

Si zgjidhet Asambleja e Përgjithshme? Çfarë risie të mirë sjell në ekonomi për qytetarët shqiptarë krijimi i këtyre korporatave?

Elton Haxhi – Korporata nuk angazhohet në pronë private, por si kontribut do të marrë si transferim prona publike dhe jo private. Në lidhje me shitjen, ka të drejtë të shesë, sepse e ka në projektligj, pasi presupozohet që prona do të zhvillohet dhe më pas mund të shitet pas zbatimit të një projekti.

Si ishte pyetja e tretë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duke nxitur zhvillimin dhe punësimin, zhvillimin ekonomik dhe përdorimin e pronave që nuk janë përdorur deri tani. Për sa i përket asamblesë është ministri i Ekonomisë ai që zgjedh, sepse ai është aksioneri i vetëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, sepse mund të ketë një ristrukturim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra ai që ka funksionet e ekonomisë.

Arben Ahmetaj – Qëndrimet do t'i kemi një nga pozita dhe një nga opozita për të qenë racionalë.

Do t'ju lutesha të mos përsërisni pyetjet!

Edlira Hyseni – Meqenëse disa nga pyetjet u ezauruan, unë do të bëj dy pyetje, zoti Haxhi.

Ky projektligj krijon efekte financiare pasi krijohet një strukturë e re shtetërore dhe nga buxheti i shtetit janë parashikuar 368 milionë lekë si kapital fillestar, por në nenin 6 korporata mund të financohet edhe nga buxheti i shtetit, ku në pikën dy të kësaj dispozite, ky financim do të jetë në formën e ndihmës shtetërore. Sa është i mundur ky financim nga buxheti dhe a ka një shumë, pra një tavan se sa mund të jetë ky financim?

E dyta, sa transparente do të jetë administrimi i fondeve, administrimi i pronës publike dhe shtetërore? A do të respektohet parimi i konkurrencë së lirë dhe efektive në përputhje me kuadrin ligjor?

Arben Ahmetaj – Zoti Haxhi, ju lutem!

Elton Haxhi – Në lidhje me financimin, përveç kontributit fillestar në kapitalin e kësaj korporate nuk ka ndonjë parashikim në buxhetin e vitit të ardhshëm. Megjithatë, gjatë hartimit të buxhetit, qeveria do të konsiderojë nëse do të ketë nevojë edhe për rritjen e

kapitalit në vitet e ardhshme, por nuk ka ndonjë plan për momentin. Këto fonde janë të mjaftueshme për fillimin e aktivitetit të korporatës dhe për ngritjen e gjithë strukturës së korporatës dhe mirëfunksionimin e saj. Transparenca e përdorimit të fondeve sigurohet nëpërmjet auditimit nga audituese të pavarur dhe nga KLSH-ja. Konkurrenca sigurohet nëpërmjet respektimit të legjislacionit të konkurrencës dhe ndihmës shtetërore. Është një sh.a si të gjitha sh.a-të e tjera me përjashtim se ka kapital fillestar dhe aksionar të vetëm ministrin e Ekonomisë. E gjithë forma e funksionimit është si të gjitha sh.a-të e tjera.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Kush do të shprehë qëndrimin në emër të opozitës?

Po, zoti Roshi.

Artur Roshi – Në gjykimin tim, pas studimit që i bëra projektligjit dhe procesverbalit mbështetës, gjykoj se krijimi i një korporate shtetërore na kthen pas, për të mos thënë që është fundi i tregut të lirë në një ekonomi kapitaliste. Kjo korporatë shtetërore ka probabilitetin e madh të dështojë, sepse në kemi eksperiencën e të gjitha kompanive shtetërore përfshirë këtu para se të privatizojë Alb telekom ose kompani të tjera. Dimë që të gjitha kompanitë shtetërore ose ndërmarrjet shtetërore nuk kanë funksionuar dhe prandaj i jemi drejtuar sistemit privat. Ky është koncepti i kapitalizmit. Pra, tregu i lirë është ai që duhet t'i drejtohem dhe jo të kthehem te modele të vendeve të prapambetura, jo të vendeve të zhvilluara. Ne themi që jemi vend i Europës dhe nuk kemi asnjë korporatë që të funksionojë kështu në vendet e qytetërimit Perëndimor dhe në vendet e Europës, por marrim modele të tilla në Meksikë, Kili apo në vende të tjera që nuk janë për modele zhvillimi, pavarësisht se çfarë nivel zhvillimi kanë.

Kështu që, krijimi i këtyre korporatave godet rëndë tregun e lirë. Është në një farë mënyre zgjerim i influencave të qeverisë, të partisë shtet që po qeveris. Pas PPP-ve është e vetmja gjë e fundit që ka mbetur si limit për të zgjeruar influencën e saj.

Nëse tregu prodhon i lirë iks para, këto para mund të investohen dhe ne nuk mund të marrim borxh disafishin e tyre. Pra, vë re që vëmendja e qeverisë është vetëm në kredimarrje dhe nën petkun e investimit se po bën investime për të rritur ekonominë, nuk matet apo nuk ka autokontroll në marrjen e kredive.

Ne nuk mund të hapim qindra mijëra fronte investimesh pa sens. Investime bëhen aq sa kërkon tregu. Do të krijohet një korporatë dhe do të bëj investime kaotike. Kjo nuk është zgjidhje për ekonominë. Zgjidhjet kaotike nuk i shërbejnë ekonomisë së vendit, sepse nuk ka asnjë element studimi.

Për sa u përket ekspertëve të Harwardit, ata shkojnë në Kinë dhe në çdolloj vendi që do t'i marrë, unë mendoj se korporata e kthen në modelin rus dhe kinez. Ne nuk mund të kthehemi pas, por duhet të ecim para dhe ta çlirojmë tregun nga kthetrat shtetit dhe jo ta forcojmë atë, siç bëhet në këtë rast.

Në relacionin mbështetës të këtij projektligji thuhet se kjo korporatë ka për qëllim të përgatisë projekte, sepse biznesi nuk ka fuqi investuese. Kjo do të thotë që biznesi po lëngon. Pra, në qoftë se ti biznesit i heq riskun për t'u futur në treg, do të thotë që nuk ka fuqi apo nuk ekziston. Në këtë moment nuk zgjidhet problemi me futjen e kësaj korporate, vetëm zhvendoset nga biznesi privat, që është duke lënguar dhe falimentuar tërësisht, sepse nuk ka një treg të lirë, te dora e shtetit nëpërmjet korporatës. Pra, problemi është zhvendosur dhe nuk zgjidhet me korporatën. Të jeni të bindur se problemi nuk do të zgjidhet. Mbas PPP-ve, ky do të jetë ligji që do të ndihmojë në dështimin e ekonomisë. Pra, është ligji i dytë i famshëm për dështimin e ekonomisë. Këtë nuk e them thjesht se jam opozitar, por sepse kam bindjen se kështu funksionon ekonomia e tregut.

Kështu që, përderisa investimet nuk mund të bëhen jashtë fuqive, sepse tregu është i kufizuar, sa mund të prodhojë tregu në një situatë të caktuar? Kaq mund të jetë zhvillimi i tij. Ne nuk mund të kapërcejmë përtej tij, sepse do të krijojmë një gropë potenciale ekonomike dhe nuk do të dalim dot kurrë. Nuk kemi as ishuj për t'i shitur, si Greqia.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zonja Reme Lala.

Reme Lala – Faleminderit, zoti kryetar!

I mirëpresim të gjitha sugjerimet dhe kritikën. Pavarësisht se diskutimet ishin nën për nën dhe ka vend për përmirësime, në parim ideja është të bëhet më e mira për këtë projektligj.

Duke u bazuar në pikat që thatë ju, zoti Roshi, ky nuk është fundi i ekonomisë shqiptare, përderisa është implementuar në mënyrë të suksesshme edhe nga vendet e tjera. Nuk e di se si e matni ju nivelin e suksesit.

Keni një koncept të gabuar për korporatën, përderisa kjo korporatë është krijuar për të rritur investimet në vend dhe për të menaxhuar pronat publike dhe jo ato private, sikurse thatë ju.

Ju e cilësoni shtetin si joeficient, edhe pse nuk jam fare dakord me këtë. Prandaj është krijuar kjo korporatë, për të rritur eficiencën, për të kaluar të gjitha pronat publike dhe për t'i menaxhuar ato në mënyrë strategjike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ju lutem, mos ndërhyuni!

Ne ju dëgjuam me shumë respekt dhe nuk ndërhyrë.

Reme Lala – Kjo korporatë nuk e rrezikon aspak konkurrencën e lirë dhe nuk e konkurren aspak subjektin privat. Këtë duhet ta kuptoni edhe ju, dhe duhet ta theksojmë edhe ne nga ana jonë.

Fusha e veprimtarisë së korporatës synon të rrisë investimet në vend, të diversifikojë prodhimtarinë dhe eksportet, të krijojë një ekspertizë për hartimin dhe zbatimin e projekteve komplekse të investimit dhe për të pajisur shtetin shqiptar me një kapacitet të munguar për realizimin e investimeve. Kjo është e gjitha.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Diskutimet mbaruan.

Ju ftoj ta votojmë në parim ligjin.

Siç e theksova, zoti Haxhi, pres zyrtarisht ndryshimet, në mënyrë që ta fusim diskutimin e draftligjit në procedurën e komisionit. Duhet të vijmë, siç është edhe Rregullorja e re, nga Këshilli i Ministrave, të argumentuara sa më shpejt, në mënyrë që të jemi në harmoni me të gjitha ato që ka ngritur Komisioni European dhe institucionet financiare ndërkombëtare të zhvillimit, në mënyrë që në diskutimin nën për nën të jemi sa më të qartë dhe të kemi ezauruar edhe shqetësimet, për të qenë më eficient në hartimin e neneve, pasi ju të na i keni dërguar zyrtarisht ato që ju kërkoja në momentin e parë.

Kush është pro projektligjit për korporatën e investimeve shqiptare, në parim? Kush është kundër? Abstenim?

Miratohet.

Presim dokumentet dhe letrën e komisionit, gjithashtu.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti